

PROTOKOLL

NDËRMJET

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

**MINISTRISË SË BRENDSHME TE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR**

**REGJIMIN E TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT NË ZONAT KUFITARE NDËRMJET
KUFIRIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, më poshtë të referuara si “Palët”:

Në kuadër të marrëdhënieve të shkëlqyera që ekzistojnë mes dy vendeve;

Duke vepruar sipas interesit të ndërsjellë, me synim përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e gjendjes civile;

Duke vepruar sipas parimit të barazisë dhe interesit të ndërsjellë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, rregullat e procedurat e vendeve të tyre;

Në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit”, nënshkruar më datë 26 nëntor 2021, (në vijim e referuar si “Marrëveshja”)

Kanë rënë dakord sa vijon:

Neni 1 Fusha e zbatimit

Ky protokoll përcakton rregullat e regjimit të Trafikut Lokal të Kufirit, në zonat kufitare ndërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Neni 2 Përkufizime

Sipas këtij Protokoll, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

1. **“Kufi tokësor”** - nënkupton një vijë kufiri të përbashkët tokësor, në mes dy vendeve;
2. **“Palët”**- nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë.
3. **“Organ Kompetent”**- nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme në Republikën e Kosovës dhe Ministrinë e Brendshme në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë dhe institucionet e varësisë në kuadër të këtyre ministrive;
4. **“Zonë Kufitare”**- nënkupton një zonë në territorin e Palëve, e cila shtrihet jo më larg se 30 kilometra nga kufiri tokësor.
5. **“Banorë të zonës kufitare”**- janë shtetasit e palëve në këtë Marrëveshje, të cilët janë banues të ligjshëm në një zonë kufitare jo më pak se një (1) vit dhe kanë të drejtë të pajisen dhe të përdorin një leje për qarkullim në zonën kufitare. Në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, të specifikuara me këtë marrëveshje apo protokolleve të saj, periudha e qëndrimit prej më pak se 1 (një) vit po ashtu mund të konsiderohet si e përshtatshme;
6. **“Leja e trafikut lokal kufitar”**- nënkupton një dokument të veçantë, i cili lejon banorët e zonës kufitare të kalojnë kufirin shtetëror dhe të qëndrojnë në zonën kufitare siç përcaktohet në Marrëveshje.
7. **“Trafiku lokal kufitar”** nënkupton kalimin e rregullt të pikës së kalimit kufitar apo edhe jashtë pikës së kalimit kufitar, ashtu siç përcaktohet në këtë protokoll, nga banorët e zonës kufitare, me qëllim të qëndrimit në zonën kufitare të palës tjetër nënshkruese, për arsye sociale, kulturore, arsimore, familjare, shëndetësore ose arsye të vërtetuara ekonomike, për një periudhë që nuk tejkalon afatin kohor të përcaktuar në protokoll.

Neni 3

Kriteret e hyrjes dhe të qëndrimit

1. Banorët e zonës kufitare, të cilët janë të pajisur me leje të trafikut lokal kufitar, të vlefshme për qarkullim në zonat kufitare të shoqëruar nga një dokument i vlefshëm identifikimi, mund të udhëtojnë dhe qëndrojnë në zonën kufitare.
2. Qëndrimi nuk do të jetë më i gjatë se 90 ditë brenda 180 ditëve.
3. Gjatë qëndrimit të tyre, siç përcaktohet në Marrëveshje, nuk çenohet zbatimi i legjislacionit përkatës për të huajt që kanë të bëjnë me:
 - a. Qëndrimin afatgjatë;
 - b. Kryerjen e aktiviteteve ekonomike; dhe
 - c. Çështjet doganore dhe tatimore.

Neni 4

Leja e trafikut lokal të kufirit

1. Leja e Trafikut Lokal Kufitar lëshohet për shtetasit e vet nga autoriteti kompetent i Ministrive të Brendshme të palëve, mbështetur në kërkesën e shtetasve që i plotësojnë kushtet për këtë të drejtë.
2. Afati i vlefshmërisë së Lejes të Trafikut Lokal Kufitar është vlerësim dhe kompetencë e Autoritetit Lëshues, bazuar në kërkesën e aplikantit, me kohëzgjatje maksimale deri në 5 vite.
3. Leja e Trafikut Lokal Kufitar jepet brenda një afati prej 5 ditë pune, nga parashtrimi i kërkesës.
4. Palët njohin dhe pranojnë respektivisht lejet e trafikut lokal kufitar.
5. Tarifat për aplikimin për pajisjen me leje të trafikut lokal kufitar, nëse ka, përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse të palëve.
6. Palët hartojnë regjistra të vecantë për lejet e lëshuara nga ana e tyre.
7. Palët, sipas nevojës, bashkëpunojnë për verifikimin e dokumenteve të lëshuara nga ana e tyre, si dhe caktojnë pika kontakti, përfaqësues nga autoriteti përgjegjës i lëshimit të Lejeve.
8. Palët mund të miratojnë si leje të trafikut lokal edhe dokumentin e identifikimit (letërnjoftimin) shtetëror, nëse përmbushin kërkesat dhe kriteret e parashikuara në Marrëveshjen e trafikut lokal kufitar.

9. Palët do të këmbejnë përmes kanaleve zyrtare specimenet e lejeve të trafikut lokal kufitar, para fillimit të implementimit të protokollit.

10. Format i lejes dhe përmbajtja e aplikimit për Leje, janë pjesë e këtij Protokollit, sipas shtojcës “c”, bashkëlidhur.

Neni 5 **Zonat e kalimit kufitar**

1. Zonat e kalimit kufitar, janë sipas përcaktimit në nenin 6, të Marrëveshjes.
2. Lista e qyteteve dhe fshatrave që të Palëve, të cilat përfshihen brenda zonës kufitare 30 km, janë pjesë e këtij Protokollit, sipas shtojcës “a” Republika e Shqipërisë dhe “b” Republika e Kosovës, (Bashkëlidhur Protokollit).
3. Në rast se ndonjë pjesë e një njësie (qyteti/fshati) ndodhet brenda zonës 30 kilometra, atëherë e gjithë njësia (qyteti/fshati) konsiderohet si pjesë e zonës kufitare.
4. Për palën e Kosovës, njësi bazë është Komuna. Për palën Shqiptare, njësi bazë është Njësia Administrative.

Neni 6 **Vendkalimet e veçanta kufitare**

1. Palët marrin në vazhdimësi masat e duhura për lehtësimin e kalimit të kufirit shtetëror. Këto masa përfshijnë:
 - a. Autoritetet vendore të kufirit të Palëve, përcaktojnë bashkërisht dhe me plan vendosje, vendkalime të veçanta kufitare të destinuara vetëm për trafikun lokal të kufirit.
 - b. Vendkalimet e veçanta të kalimit lokal të kufirit duhet të jenë vende të përzgjedhura të terrenit, në mënyrë që të krijojnë lehtësira për kalim kufitar të banorëve të zonës kufitare, si dhe në rast verifikimi kufitar nga rojet kufitare.
 - c. Vendkalimet e veçanta të kalimit lokal të kufirit, në varësi të terrenit duhet të kenë hapësirën e nevojshme për kalim kufitar, por jo më të gjëra se 10 metra.
 - d. Kalimi i kufirit nga banorët e zonave kufitare, bëhet në këmbë dhe vetëm në vendkalimet e veçanta të kalimit lokal të kufirit.

Neni 7

Kontrolli kufitar

1. Në lejet e trafikut lokal të kufirit, nuk vendosen vula hyrëse dhe dalëse.
2. Poseduesi i lejes së trafikut lokal kufitar, në çdo kohë duhet të ketë me vete lejen e trafikut lokal të kufirit bashkë me dokumentin e vlefshëm të udhëtimit (ID kartë, pasaportë) dhe ta paraqesë atë sa herë që kërkohet nga roja kufitare.
3. Palët mund ti regjistrojnë në çdo kohë të gjithë hyrje-daljet dhe qëndrimet e banorëve të zonës kufitare për nevoja të veta statistikore dhe të sigurisë.
4. Në vlerësim të Autoriteteve Kufitare, mund të kryhet edhe verifikim i plotë kufitar i banorëve të zonave kufitare që janë të pajisur me leje të trafikut lokal të kufirit. Ky kontroll kryhet në intervale jo të rregullta kohore.
5. Në interes të banorëve të zonës kufitare, për qëllime të evidentimit të hyrjes-daljes dhe qëndrimit në territorin tjetër, autoritetet e pikave të kalimit kufitar, me kërkesën e tyre mund t'i lëshojnë një vertetim, në të cilin shënohet data, vendi dhe pika e kalimit kufitar.

Neni 8

Rinovimi i Lejes

1. Banorët e zonës kufitare të Palëve, të cilët gjatë qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër, humbasin Lejen e Trafikut Lokal të Kufirit, duhet të paraqiten menjëherë tek Autoriteti Vendor i Policisë Kufitare.
2. Autoriteti Vendor i Policisë Kufitare, lëshon një dokument njoftimi ndihmës të përkohshëm, sipas procedurave administrative të palëve, me afat vlefshmërie deri në 7 ditë. Ky dokument njoftues duhet të paraqitet në pikën e kalimit kufitar dhe pranë Autoritetit Vendor, i cili ka lëshuar lejen e humbur.
3. Banorit të zonës kufitare, të cilit i ka humbur leja, i lëshohet leja e re nga Autoriteti kompetent, brenda 30 ditëve nga momenti i paraqitjes së njoftimit për lejen e humbur.
4. Në rast skadimi ose dëmtimi, leja e trafikut lokal kufitar mund të ripërtërihet sërish me afat deri në 5 vite, sipas kërkesës së banorit të zonës kufitare.

Neni 9
Kalimi në pikat e kalimit kufitar

1. Banorët e zonës kufitare të cilët zotërojnë lejen e trafikut lokal kufitar mund të kalojnë kufirin edhe në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar.
2. Autoritetet e Pikave të Kalimit Kufitar, mund të rezervojnë linja të veçanta për banorët e zonës kufitare në pikat e kalimit kufitar të përhershme.
3. Kalimi i banorëve të zonave të kufitare në pikat e kalimit kufitar, i nënshtrohet të njëjtit regjim si në zonat e kalimit kufitare të trafikut lokal.
4. Kalimi i tyre bëhet në korsi të veçanta ose vende të dedikuara duke treguar lejen e trafikut lokal të kufirit.
5. Banorët e zonave të trafikut kufitar lokal, të cilët nuk janë të pajisur me lejen e trafikut lokal të kufirit, gjatë kalimit në pikat e kalimit kufitar i nënshtrohen të njëjtave procedura si gjithë shtetasit e tjerë.

Neni 10
Legjislacioni i zbatueshëm

1. Personat që kalojnë kufirin lokal kufitar dhe qëndrojnë në territorin e Palës tjetër në përputhje me kushtet e këtij Protokolli, duhet të respektojnë dhe zbatojnë legjislacionin e palës pritëse.
2. Banorët e zonës kufitare, nuk mund të udhëtojnë apo të qëndrojnë jashtë zonës kufitare të përcaktuar në këtë marrëveshje.
3. Mosrespektimi i kësaj dispozite konsiderohet qëndrim i paligjshëm dhe i nënshtrohet masave të duhura konform legjislacionit shtetëror të secilës palë.

Neni 11
Shfuqizimi i lejes

1. Shfuqizimi i Lejes mund të bëhet nga Autoriteti kompetent, për arsye të dyshimeve të sigurisë, shkeljeve ligjore dhe shkeljeve të rregullave të qarkullimit kufitar lokal, të cilat mund të kryhen në territorin e palës, si dhe për ndryshime të kushteve sipas të cilave është përfituar.
2. Në rast shfuqizimi, Leja e Trafikut Lokal Kufitar bëhet e pavlefshme nga Autoriteti lëshues dhe i kërkohet zotëruesit ta dorëzojë menjëherë atë.
3. Nëse ndonjë nga banorët e zonës kufitare bëhet subjekt i një mase të ndalimit të hyrjes në territorin e palëve, apo vlerësohet nga Autoritetet e Palëve si kërcënim për rendin publik,

sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrëdhëniet ndërkombëtare, leja shfuqizohet menjëherë.

4. Palët njoftojnë menjëherë njëra tjetrën kur shfuqizohet leja e banorëve të zonës kufitare.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Protokolli do të zgjidhet nga Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve (KPE).

2. Nëse KPE nuk do të jetë në gjendje të gjejë një zgjidhje të pranuar nga të dy palët brenda tre muajve, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me bisedime dypalëshe nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 13

Dispozita përfundimtare

1. Ky protokoll është i vlefshëm për një periudhë të papërcaktuar kohore dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët.

2. Protokollin, mund të ndryshohet me pëlqimin e të dy Palëve nënshkruese, përmes shkëmbimit të notave verbale.

3. Protokollin, mund të denoncohet nga secila palë nënshkruese, përmes rrugëve diplomatike. Në këtë rast ky Protokoll do të pushojë së ekzistuari gjashtë (6) muaj nga data e marrjes me shkrim për ndërprerjen e tij.

Ky Protokoll nënshkruhet më 20.06.2022, bërë në Prishtinë, në dy origjinale secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike dhe njëloj të barasvlershme.


Në rast mosmarrëveshje në interpretimin e këtij Protokolli, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**Për Ministrinë e Punëve të Brendshme
të Republikës së Kosovës**

Xhelal SVECLA

**Për Ministrinë e Brendshme
të Republikës së Shqipërisë**

Bledar ÇUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË (Shtojca "a")

Për qëllime të këtij Protokolli të Marrëveshjes, emrat zyrtarë të qyteteve/fshatrave të cilat ndodhen në rrezen 30 kilometra nga kufiri Shqipëri - Kosovë, konsiderohen:

BASHKIA KUKËS:

Kolsh, Mamëz, Myç – Mamëz, Shëmri, Shtanë, Petkaj, Mgulle, Çam, Gdheshte, Pistë, Spas, Shikaj, Dukagjin, Kalimash, Kryemadh, Bushat, Bicaj, Osmane, Mholaj, Mustafaj, Nangë, Kolesjan, Domaj, Gabricë, Tërshenë, Lusën, Zallë, Malqene, Resk, Ujmisht, Skavicë, Tejdrine, Morinë, Bardhoc 1, Bardhoc 2, Breg - Lumë, Pobreg, Gjeggjan, Shtiçën, Koder Lume, Krenze,

Gjallicë, Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Shtrezë, Borje, Oreshkë, Ceërnalevë, Orgjost, Kosharisht, Pakisht, Zapod, Orçikël, Bele, Lojmë, Topojan, Xhaferraj, Turaj, Brekije, Nimçë, Bushtrinë, Gjegje, Matranxh, Palush, Vilë, Barruç, Shpat, Fshat, Çajë, Buzëmadhe, Shkinak, Gështejë, Kodër-Gështejë, Kalis, Gurrë, Pratisht, Çinamak, Fusharë, Surroj, Aliaj, Arrën, Arrëz, Barrë, Vërrij, Tejmollë, Kukës, Gostil, Drinas.

BASHKIA KRUMË:

Golaj, Nikoliq, Bardhaj, Perollaj, Vlahen, Letaj, Peraj, Dobrunë, Zgjeç, Qarr, Helshan, Kosturr, Fajza, Vranisht, Tregtan, Likeni i Kuq, Metaliaj, Brenogë, Gjinaj, Pusi i Thatë, Myç - Has, Domaj, Pogaj, Kishaj, Krumë, Gajrep, Cahan, Mujaj - Dajç, Zahrishit.

BASHKIA BAJRAM CURRI:

Bajram Curri, Astë, Kojel, Viçidol, Kasaj, Gegaj, Buçaj, Papaj, Sopot, Babinë, Begaj, Shumice-Ahmetaj, Myhejan, Kovaç, Kërrnajë, Shkëlzen, Brisë, Salce, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshe, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipëm, Margegaj, Fushë Lumi, Koçanaj, Shoshan, Lagja Paqës, Bradoshnicë, Dragobi, Çerem, Valbonë, Rragam, Bukovë, Jaho Salihi, Llugaj, Luzhë, Rrez - Mali, Rragam, Bujan, Rosujë, Dojan, Markaj, Gri, Lekurtaj, Selimaj, Bllatë, Gri e Re, Pac, Zherkë, Vlad, Çorraj, Çorraj-Veliç, Berishë, Visoçë, Mash, Zogaj, Prush, Kepenek, Karn, Leniq, Tpla, Dushaj i Poshtëm, Degë, Breg - Lum.

REPUBLIKA E KOSOVËS (Shtojca "b")

Për qëllime të këtij Protokollit të Marrëveshjes, emrat zyrtarë të qyteteve/fshatrave të cilat ndodhen në rrezen 30 kilometra nga kufiri Kosovë - Shqipëri, konsiderohen:

Komuna e Gjakovës:

Koshare, Mulliq, Brovinë, Batushë, Ponoshec, Morinë, Potok, Babaj i Bokës, Shishman, Popoc, Smolicë, Stubëll, Berjahë, Nec, Ramoc, Madanaj, Korenicë, Duzhnje, Devë, Meje, Jahoc, Brekoc, Guske, Vogovë, Zhub, Goden, Prush, Zylfaj, Firzë, Moglicë, Lipovec, Gërçinë, Pjetershan, Bistazhin, Dol, Kusar, Zidi i Sadik Ages, Kushavec, Damjan 1,2,3, Ujz, Fshaj, Rogovë, Raçë, Marmull, Bordosanë, Zona Kadastrale Jahoc, Zona Kadastrale Gjakovë qytet, Rrezinë, Qerim, Doblbare, Vraniq, Bec, Kodrali, Lugbunar, Rracaj, Pacaj, Dallashaj, Dobrosh, Sheremet, Piskotë, Osek Hylë, Osek Pashë, Skivjan, Dujakë, Hereq, Novosellë.

KOMUNA JUNIK:

Junik, Gjocaj, Jasiq.

KOMUNA DEÇAN:

Gryka e Deçanit, Hulaj, Pobergjë, Voksh, Sllup, Baballoç.

KOMUNA PRIZREN:

Kushnin, Gorozhup, Milaj, Planeje, Kabash i Hasit, Lubizhdë e Hasit, Gjonaj, Vermice, Shkoza, Zhur, Dedaj, Romaj, Lukinaj, Krajk, Mazrek, Kojushë, Nashec, Atmaxhë, Tupec, Landovicë, Piranë, Krushë e Vogël, Grazhdanik, Kobaj, Muradem, Vllashnje, Poslisht, Zym, Hoqe e qytetit, Malësi e Vrrinit, Leskovec, Dobrusht, Plavë.

KOMUNA RAHOVEC:

Krushë e Madhe, Xerxe, Fortesë, Hoçë e vogël, Pataçan, Dejnë.

KOMUNA DRAGASH:

Brezne, Buge, Rapga, Kerstaci i Madh, Vranishtë, Orgushë, Glloboqicë, Krushevë, Gllobociqa 2, Restelicë, Brod, Zapllusha, Mlik, Zli Potok, Kukajan, Brodosanë, Zerze, Shajne, Rence, Blaq, Bellobrad, Brut, Zgatar, Kapre, Buzec, Kuk, Kosav, Plajnik, Kuklibeg.

**FORMATI/SPECIMENI I LEJES SË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT DHE
FORMULARI I APLIKIMIT (Shtojca "c")**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME

APLIKIM PËR LEJE TË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

APPLICATION FOR LOCAL BORDER TRAFFIC PERMIT

Ky formular është për të aplikuar për leje të trafikut lokal të kufirit në Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes formularin e aplikimit. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Lexoni udhëzimet për plotësimin e formularit në www.asp.gov.al → English → Application forms. Sqarimet që ju duhet të bashkëlidhni në aplikimin tuaj janë të shënuara në seksionin A të këtij formulari.

This form is for applying for a Albanian local border traffic permit. Carefully fill in the application form. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. Read the instructions for filling in the form at www.asp.gov.al → English → Application forms. Clarifications that you need to append to your application are listed in Section A of this form.

Aplikim për
Application for

LEJE për herë të parë
A first local border traffic permit

Rinovim LEJE
Renewed local border traffic permit

dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:
and hereby submit the following information for the processing of my application:

Deklarime / Declarations

Foto

Photo

Unë po aplikoj për një leje të trafikut kufitar lokal në Shqipëri. Konfirmoj se, informacioni dhe dokumentet e paraqitura në këtë aplikim janë korrekte dhe te sakta. Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacion të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e lejes së trafikut kufitar lokal ose të heqjes së lejes ekzistuese, si dhe refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipërisë.

I am applying for a Albanian local border traffic permit. Hereby affirm that the information I submit in this application and its appendices is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a local border traffic permit or the cancelling of an existing permit, as well as the refusal of entry into the Albanian territory.

DEKLARUESI:
THE DECLARANT:

Aplikanti
Himself

Personi i autorizuar
The person authorized

Emer/Name, Mbiemer/Surname

Mbiemri / Family name

Emri / First name

Datëlindja (dd.mm.yyyy)
Date of birth

Numri Kartës Identitetit/Pasaportës
Identity Card / Passport Number

Shteti i lindjes
Country of birth

Vendi i banimit/Qyteti/Fshati / Place of residence

Gjinia /Gender:

Mashkull / Male

Femër / Female

E panjohur / Unknown

Shtetësia (të) / Current citizenship(s)

Zona Kufitare

Motivi i kalimit lokal të kufirit

A keni ndalim hyrje në territorin e RSH ?

Do you have an entry ban in the territory of the Republic of Albania ?

Afati i Lejes / Term of Permit**Unë aplikoj për leje kalimi me afat / I'm applying for a permit term:****Afresa e plotë e aplikantit / Information of Applicant**

Nëse informacioni ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj.

If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.

Bahkia Municipality	Njësia Administrative Administrative Units		
Fshati/Qyteti City / Town	Rruga Street		
Ndertesa nr. Building No.		Hyrja The Entrance	
Kodi Postar Postal Code		Apartamenti Appartment	
Tel. / Cel. / Fax			
E-mail:			

Vendi dhe data

Place and date

Nënshkrimi
SignatureEmri me shkronja kapitale
Name in block letters**SEKSIONI A / SECTION A****Shtojca të detyrueshme / Oblicatory appendices**

Më poshtë janë listuar sqarimet e nevojshme si shtojcat në këtë aplikim për leje të trafikut lokal të kufirit. Gjatë aplikimit duhet të ngarkohen dokumente origjinale dhe deklarata.

The clarifications listed below are required as appendices to this local border traffic permit application. The original documents and clarifications must be uploaded when submitting the application;

Bashkëngjitni sqarimet me aplikimin dhe shënoni kutitë poshtë si të përshtatshme.
Enclose the clarifications with the application and tick the boxes below as appropriate.

- Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit (pasaportë, kartë identiteti)
Photocopy of valid travel document (passport, ID Card)
- Një fotografi (47mmX36mm), të bërë jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit
Passport photo (47mmX36mm),
- Deklaratë/autorizimi
Declaration/ authorization
- Dokumente të tjera
Other documents

*Para përfundimit të aplikimit, duhet të ngarkoni mandatin e pagesës (pagesë për leje të kalimit lokal të kufirit)
*Before completing the application, you must upload the mandate of payment (payment for local border traffic permit)

SEKSIONI B / SECTION B

Për tu plotësuar nga zyrtari që pranon aplikimin
To be filled out by the official person to whom the application was submitted

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

Tipi i lejes që përfitohet:

LEJA E KALIMIT LOKAL TË KUFIRIT Afati: _____

_____, më: _____

Nënshkrimi i zyrtarit: _____

E-leje e kalimit lokal të kufirit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

LEJE E KALIMIT KUFITAR LOKAL
LOCAL BORDER TRAFFIC PERMIT

Seria dhe Numri i Lejes
Series and Permission Number
BG 239200

Foto
Photograph

EMRI (AT), MBIEMRI _____

Firs name (s), Family name

VENDLINDJA _____

Place of birth

DATËLINDJA dd.mm. yy

Date of birth

NUMRI I PASAPORTËS/DOKUMENT IDENTIFIKIMI _____

Passport Number/ Identification document

SHTETËSIA _____ GJINIA _____

Nationality

Sex

ADRESA E VENDBANIMIT _____

Residential Address

ZONA KUFITARE _____

Border Area

Kjo leje e kalimit kufitar lokal, është e vlefshme nga data dd.mm. yy deri më dd.mm. yy

This Local Border Traffic Permit is valid from _____ until _____

DREJTORI I DVKM

Director

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit

QR Code

